



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:255576

Datë: 03.11.2020

Numri i dokumentit: 01240838

P.nr. 1019/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit A. R. nga, i akuzuar për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope , ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II. nr.2452/19, të dt.04.11.2019, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, të dt.13.10.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Suada Hamza, të pandehurit A. R., në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.03.11.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A. R., i lindur me dt., në, me vendbanim në, rr. “.....”, banesa, kati ..., nr. ..., i biri i H. dhe nënës H., e gjinisë B., i njohur sipas nr. personal, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor i thjeshtë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon nr. tel., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

- Me dt.13.09.2019 orës 02:50 min, rr.”.....” K-, pa autorizim posedon substanca narkotike dhe atë narkotikun e llojit “.....” me sasi rreth 0.9 gram, në atë mënyrë që natën kritike gjer sa i pandehuri ishte në automjetin e tipit “.....” me targa të regjistrimit e në të cilën veturë kishin qene edhe tre persona tjerë dhe me të arritur tek vendi

i lartcekur ishin ndaluar nga një patrulle e policisë dhe gjate kontrollit fizik ne xhepin e pantallonave tek i pandehuri kane gjetur dhe sekuestruar substancën ne fjale.

-Me çka ka kryer vepër penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope , ose analoge nga neni 269 par. 2 te KPRK-së.

Andaj gjykata në aplikim të në nenin 7, 38, 39, 46, 47,48, 49, dhe nenit 269 par.2 dhe 3 te KPRK-së, nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

DËNIM ME KUSHT

- Të Pandehurit i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, mirëpo ky dënim nuk do te ekzekutohen në rast se e pandehuri brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ndaj të pandehurit në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së, shqiptohet

DËNIMI PLOTËSUES –KONFISKOHET- narkotikun e llojit me sasi prej 0.9 gram.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr. 2452/19, të dt. 04.11.2019, kundër të pandehurit A. R., posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope , ose analoge nga neni 269 par. 1 te KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 13.10.2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar prezent ishin Prokurori i shtetit Suada Hamza dhe i pandehuri A. R..

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës nuk dua të angazhojë ngase nuk kam nevojë.

Para leximit te aktakuzës Prokurori i Shtetit, bën rikualifikimin e veprës penal dhe atë nga par.1, i nenit 269, në par.2, të nenit 269, të KPRK-së, meqenëse sasia e narkotikut të gjetur tek

i pandehuri është më pak se 3 gram dhe nuk ka dëshmi se i njëjti ka qenë i dënuar më parë me aktgjykim të plotfuqishëm, andaj në prezencën e këtyre rrethanave e ri kualifikojë me paragrafin 2. Pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pandryshuar.

Pas leximit të aktakuzës së ri kualifikuar nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, premtun se nuk do të përsëris më vepra tjera penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës. Ndërsa pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka propozuar që ta merre si rrethanë lehtësuese.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i oficerit Afrim Kastrati ID 5259 dt. 13.09.2019, raporti i hetuesit policor Gani Krasniqi ID 3945 te dt. 14.09.2019, deklarata e të pandehurit A. R.e dhënë në polici me dt. 14.09.2019, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër- DA-.....te dt. 14.09.2019, raporti i analizës së narkotikut te dt. 25.09.2019, lista e dëshmimeve e dt. 14.09.2019, fotografit e narkotikut dhe vendi i ngjarjes, si dhe shkresat e lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Aaron Rexhaj, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope, ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri ishte i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, ndërsa si rrethana rënduese

ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti. Gjykata pati parasysh faktin se i pandehurit dyshohet edhe për vepra tjera penale, mirëpo duke pasë parasysh parimin e prezumimit të pafajësisë së të pandehurit deri në shpalljen ose jo fajtor me aktgjykim të plotfuqishëm, gjykata faktin se i pandehuri dyshohet edhe për vepra tjera penale nuk ja konsideroj si rrethanë rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 269 par.3 të KPRK-së gjykata ka konfiskuar narkotikun e llojit me sasi prej 0.9 gram.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.1019/19 dt. 03.11.2020**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.